



Bio Tartar Bazaj, Zv. Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Është zgjedhur Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me Vendimin Nr.19, datë 08.02.2018, nga Kuvendi i Shqipërisë nga radhët e avokatisë.

Është Kryetar i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Ka mbajtur funksionin e Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve, dhe Anëtarit të Komisionit të Disiplinës, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Është diplomuar për Drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë. Përvoja e tij e punës përfshin detyra dhe emërimë të ndryshme ndër vite.

Me Vendimi Nr.1 datë 31 Mars 1995 të Këshilli të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë deri në qershor të vitit 2000. Nga periudha 03 Janar 2001 - 05 Shkurt 2018, ka ushtruar profesionin e avokatit. Ka themeluar dhe drejtuar Studion Ligjore "BAZAJ" Sarandë - Tiranë.

Përgjatë viteve 2008-2012 ka qenë Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatëve të Shqipërisë. Në vitin 2012 ka botuar librin monografik dedikuar krahinës së tij "Shkoza dhe Baba Arshi Bazaj".

Ka qënë pjesëmarrës aktiv por edhe sponsor në organizime të ndryshme me karakter kulturor humanitar dhe atdhetar si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Z. Bazaj ka qënë disa herë i ftuar nga Diaspora Shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ka dhënë edhe intervista televizive lidhur me drejtësinë dhe historinë e krahinës së Labërisë etj.

Është lektor i jashtëm "Titullar Lënde, në Kriminalistikë, Kriminologji Penologji dhe Elementët e Kriminologjisë Klinike.

Mandati i tij në detyrën e Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është një mandat me afat pesë vjeçar, i vlefshëm nga Dhjetori 2018 deri në Dhjetor 2023.